**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIMOZA SADUSHAJ**
**ADRESA rruga Vaso Pasha, pallati 13/1**
**Tirane**
**TEL: 0692097547**

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

**Nr. repertori: 525** **Nr. koleksioni: 174**

**Tirane më 08/02/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053540019033162

*Akti noterial përbëhet nga 12 fletë

A2021053540019033162

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ME ORTAK TË VETËM

# "TATAMI GROUP SH.P.K"

Sot, më datë 8/02/2021, përpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqit personalisht:

**THEMELUES:**
Alessio Rinelli, atësia Ruggiero, amësia Donatella Vittoria, shtetas Italian, lindur në Cernusco sul Naviglio, Milano dhe banues ne Milano, lindur më 07/06/1983, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID me nr. CA76512DJ.

I cili harton këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë **"TATAMI GROUP" SHPK,** mbështetur në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

## KAPITULLI I
## THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA
### Neni 1 – Forma

1.1. Shoqëria "TATAMI GROUP" Sh.p.k. themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe funksionon sipas këtij statuti dhe aktit të saj të themelimit.

1.2. Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

### Neni 2 – Emërtimi

2.1. Emërtimi i shoqërisë është "TATAMI GROUP" Sh.p.k.

### Neni 3 – Objekti i shoqërisë

3.1. Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryesisht, por jo vetëm, veprimtaritë në fushën e komunikimit dhe marketingut dixhital dhe jo dixhital, si më poshtë, por pa kufizim:

3.1.1. Konkretisht:

a) Zhvillimin, prodhimin, menaxhimin dhe tregtimin e produkteve dhe/ose shërbimeve inovative me vlerë të lartë teknologjike, shërbimeve informatike dhe telematike inovative;
b) Konsulencë të asistuar në fushën e teknologjisë së informacionit me vlerë të lartë teknologjike;
c) Zhvillimin e software-ve inovativë, sistemeve të menaxhimit informatik në web dhe aplikacioneve për pajisje mobile;
d) Projektimin, menaxhimin dhe konsulencë për krijimin e hardware-ve, software-ve dhe aplikacione-ve inovative në web dhe me vlerë të lartë teknologjike;
e) Asistencë teknike lidhur me produktet informatike inovative me vlerë të lartë teknologjike;

NOTER ADUSHAJ TIRANË
A2021053540019033162

f) Zhvillimin e veprimtarive SEO, pozicionimin dhe zhvillimin e faqeve web dhe profesionale, reklamimin dhe promocionin e veprimtarive tregtare në web me metodologji inovative;
g) Menaxhim i revistave, publikimeve periodike, publikimeve të përditshme dhe faqeve në web që kanë për qëllim edhe të favorizojnë shpërndarjen e kulturës së sipërmarrjes dhe të promovojnë veprimtaritë sipërmarrëse në web;
h) Krijim dhe menaxhim i veprimtarive të telekomunikacionit me përdorim të mjeteve të zhvilluara dhe inovative nga pikëpamja teknologjike dhe/ose çdo veprimtari në fushën e ICT-së me përmbajtje të lartë teknologjike dhe inovative;
i) Përgatitje e grafikës së web-it dhe editorialeve, fushata marketingu inovative, ideim dhe regjistrim logosh, markash dhe patentash, stampim tipolitografik dhe mbi çdo material, pajisje, broshurë, prezantim online dhe prodhime në media të tjera;
j) Krijim, zhvillim, menaxhim, konsultim i asistuar për veprimtari specifike të marketingut të mediave sociale dhe të gjitha aktiviteteve të marketingut inovativ që përdorin instrumente me vlerë të lartë teknologjike;
k) Përgatitja e planeve të biznesit dhe planeve të sipërmarrjes për projekte me financim publik dhe privat dhe kontroll të menaxhimit, duke iu referuar veçanërisht projekteve inovative dhe me vlerë të lartë teknologjike;
l) Kurse formimi të lejuara dhe të autorizuara nga entet publike me ndihmën e instrumenteve të zhvilluara dhe inovative nga pikëpamja teknologjike;
m) Organizimi dhe menaxhimi i konferencave, takimeve, kongreseve, panaireve dhe çdo aktiviteti në të cilin zhvillohet informimi, njohja dhe socializimi kryesisht mbi rrjetin dhe mbi tematikat e inovacionit dhe të ideve të sipërmarrjes me përmbajtje të lartë teknologjike;
n) Përgatitje, menaxhim dhe shpërndarje e të dhënave "*big data*" lidhur me të gjitha aktivitetet e zhvilluara;
o) Ofrim shërbimesh në fushën e komunikimit, marketingut dixhital dhe shitjeve, e cila do të përfshijë, por pa u kufizuar, realizimin e reklamave, shitjen dhe promovimin online të produkteve, marketingun e mediave sociale, reklamimin me shfaqje, librat elektronikë, krijimin dhe promovimin e videove, lojrave në internet, krijimin dhe promovimin e aplikacioneve të ndryshme, krijimin dhe shitjen e websiteve, zhvillimin e teknologjisë dhe të formave të saj në fushën e komunikimit, marketingut dixhital dhe shitjeve, si dhe çdo formë tjetër të mediave;
p) Komunikimin me blerësit, konsumatorët dhe marrëdhëniet me publikun;
q) Pjesëmarrjen, financimin, sponsorizimin dhe/ose realizimin e projekteve që lidhen me ofrimin e shërbimeve në fushën e komunikimit, marketingut dixhital dhe shitjeve;
r) Shoqëria ka gjithashtu për objekt menaxhimin, si vetë ashtu edhe me pjesëmarrje të jashtme, e çdo lloj licence, konçesioni dhe të ngjashme, shitblerjen e shoqërive tregtare, pagesën dhe/ose arkëtimin e "*royalties*", menaxhimin e *joint ventures*, *franchising,* lidhjen e tipologjive të marrëveshjeve të ngjashme dhe/ose bashkëpunimeve me të tretë, si në Shqipëri, ashtu dhe jashë saj (si për llogari të saj, ashtu edhe për llogari të të tretëve).

3.1.2. Gjithashtu, shoqëria ka për objekt edhe komunikimin *non web* që përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

a) Promocionin dhe lidhjen, për llogari të saj dhe të të tretëve, e kontratave publicitare në përgjithësi, me privatë, shoqëri tregtare, ente publike dhe private që janë të interesuar për reklamimin e produkteve në gazeta, revista, broshura, periodikëve, në ekspozita dhe manifestime të çdo lloj natyre, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj;
b) Organizimin dhe drejtimin për llogari të të tretëve të zyrave të shtypit lidhur me sektorin kinematografik, televiziv, teatral, manifestimet turistike, sportive dhe të spektaklit në përgjithësi;

c) Ideimin, realizimin, përgatitjen, menaxhimin e eventeve, konferencave, mbledhjeve, prezantimeve, seminareve, performancave, koncerteve, sfilatave, tregjeve, panaireve, ekspozimeve, ekspozitave, instalacioneve, konkurseve.

3.2. Gjithashtu, shoqëria ka për objekt edhe veprimtaritë e mëposhtme në sektorin e pasurive të paluajtshme:

a) Gëzimin, menaxhimin, dhënien me qira, nënqira, hua dhe administrimin e pasurive të paluajtshme të çdo natyre dhe lloji;
b) Menaxhimin e strukturave të hotelerisë, rezidenca, shtëpi pushimesh, *bed & breakfast*, dhe ushtrimin e çdo veprimtarive akomoduese (pritëse)-turistike në përgjithësi, si në mjediset e vetë shoqërisë ashtu edhe në ato të palëve të treta;
c) Realizimin e punimeve të ndërtimit të çdo lloji dhe natyre duke përfshirë ndërtimin, ristrukturimin e pasurive të paluajtshme dhe përmirësimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi, si dhe blerjen, shitjen, shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të çdo lloji dhe natyre.

3.3. Shoqëria do të mund të blejë pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente, konsortiume, të themeluara apo në themelim, shqiptare ose të huaja, të cilat kanë objekt të ngjashëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes së qëllimeve të shoqërisë.

3.4. Më në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër që, edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përbën një veprimtari të ndaluar me ligj dhe që është në funksion të përmbushjes së objektit të shoqërisë.

### Neni 4 – Selia

4.1. Selia e shoqërisë është në Tiranë (Shqipëri), Rruga "Zonja Çurre", Ndërtesa nr. 31, Hyrja nr. 4, Ap. 2, Njësia Administrative nr. 2, 1010, Tiranë, Shqipëri.

4.2. Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Ortakut të vetëm.

4.3. Ortaku i vetëm mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

### Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## KAPITULLI II
## KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

### Neni 6 – Kapitali themeltar

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.

6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me një vlerë prej 100 (njëqind) Lekësh.

A2021053540019033162

## Neni 7 – Kontributet dhe kuotat

7.1. Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 100 (njëqind) Lekë dhe zotërohet nga Ortaku i vetëm si më poshtë:

**Alessio Rinelli**, i biri i Ruggieros, shtetas italian, lindur më 07 qershor 1983 në Cernusco sul Naviglio, Milano (Itali), mbajtës i kartës së identitetit italiane me nr. CA76512DJ, cel: +355675034568, i cili është pronar i të gjithë kapitalit të shoqërisë "TATAMI GROUP" sh.p.k.

## Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm.

8.2. Në rast rritjeje të kapitalit, kuota e ortakut do të rritet sipas shumave të përcaktuara në vendimin për rritjen e kapitalit.

## Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Ortakut të Vetëm. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortaku sipas shumave të përcaktuara në vendimin për zvogëlimin e kapitalit.

## Neni 10 – Transferimi i kuotave të kapitalit

10.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme sipas nenit 73 të Ligjit 9901, i datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar.

# KAPITULLI III
# ORTAKU I VETËM, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

## Neni 11 – Ortaku i vetëm

11.1. Organi vendimmarrës i shoqërisë është Ortaku i vetëm.

11.2. Ortaku ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

11.3. Ortaku i vetëm mund të thirret në çdo moment nga Administratori. Në çdo rast, Ortaku i vetëm duhet të marrë vendim së paku një herë në vit për të shqyrtuar dhe miratuar bilancin e periudhës ushtrimore financiare të mëparshme.

11.4. Ortaku i vetëm, nëse thirret nga Administratori, duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje e cila duhet t'i dërgohet atij – në adresën që rezulton në dokumentet e shoqërisë – të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, vendin, orën dhe datën e mbledhjes.

A2021053540019033162

11.5. Ortaku i vetëm mund të marrë vendime edhe jashtë selisë së shoqërisë, në Shqipëri apo në një vend të huaj.

**Neni 12 – Administrimi**

12.1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, emëruar prej Ortakut të vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Ai mund të rizgjidhet për të njëjtin afat.

12.2. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i takon Administratorit. Administratori do të kryejë të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, përjashtuar kompetencat të cilat i përkasin organeve të tjerë të shoqërisë sipas ligjit të aplikueshëm apo sipas këtij statuti.

12.3. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

12.4. Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, Alessio Rinelli, atësia Ruggiero, shtetas italian, lindur më 07/06/1983 në Cernusco sul Naviglio, Milano (Itali), mbajtës i kartës së identitetit italiane me nr. CA76512DJ, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë e-maili alessio.rinelli@gmail.com, cel: +355675034568, emëruar prej Ortakut të Vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Ai mund të rizgjidhet për të njëjtin afat.

**Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar**

13.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Ortaku i vetëm, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.

**KAPITULLI IV**
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 14 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

14.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

**Neni 15 – Fitimet**

15.1. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur të gjitha shumat që Ortaku i vetëm vendos t'i vërë mënjanë, i shpërndahen Ortakut, ose me vendim të tij riinvestohen apo kapitalizohen brenda shoqërisë.

15.2. Ortaku i vetëm mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve - plotësisht ose pjesërisht - për vitet financiare të ardhshme.

**KAPITULLI V**
**SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

A2021053540019033162

## Neni 16 – Shpërndarja

16.1. Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të Ortakut të vetëm.

16.2. Shoqëria nuk prishet në rast të falimentimit të ortakut.

## Neni 17 – Likuidimi

17.1. Në rast shpërndarje, shoqëria duhet të likuidohet.

17.2. Për të administruar këtë procedurë, Ortaku i vetëm emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

17.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Ortaku i vetëm do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

17.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakut.

## Neni 18 – Gjuha

18.1. Ky akt themelimi dhe statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe 3 (tre) kopje në gjuhën italiane.

## Neni 19 – Dispozita përfundimtare

19.1. Lidhur me çka nuk është parashikuar shprehimisht prej këtij statuti do të zbatohet ligji shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

19.2. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të jetë kompetente Gjykata e Tiranës.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", ia lexova palës, i cili, në prani të përkthyeses Fjoralba Zeko e deklaroi atë tërësisht në përputhje me vullnetin e tij dhe une vërtetoj nënshkrimin e tij. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij Akti Themelimi dhe Statuti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUES**

Alessio Rinelli

PËRKTHYESE

FJORALBA ZEKO

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ

A2021053540019033162

# ATTO COSTITUTIVO E
# STATUTO
# DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA A SOCIO UNICO
# "TATAMI GROUP" S.r.l.

Oggi, in data 08 /02 / 2021, davanti a me è comparso di persona il Notaio MIMOZA SADUSHAJ, membro della Camera Nazionale dei Notai, Sezione Locale TIRANA, con sede in Tirana, Via Vaso Pasha, edificio 13/1 Tirana:

**Alessio Rinelli**, figlio di Ruggiero, cittadino italiano, nato il 07 giugno 1983 a Cernusco sul Naviglio, Milano (Italia), titolare della carta di identità italiana n. CA76512DJ, numero di telefono: +355675034568

Chi redige il presente Atto costitutivo e statuto della società "**TATAMI GROUP**" S.R.L., in base alla legge n. 9901 del 14.04.2008, "Su commercianti e le società commerciali", e successive modifiche, legge n. 9723 del 03.05.2007 "Sul Centro Nazionale di Registrazione", Codice doganale, fiscale e fiscale, come segue:

## CAPITOLO I
## FORMA, DENOMINAZIONE, OGGETTO, SEDE, DURATA

### Art. 1 – Forma

1.1. La società "TATAMI GROUP" S.r.l. è costituta in forma di società a responsabilità limitata a socio unico ed è regolata dal presente statuto e dal suo atto costitutivo.

1.2. La società opera secondo la legislazione albanese.

### Art. 2 - Denominazione

2.1. La denominazione della società è "TATAMI GROUP" S.r.l.

### Art. 3 – Oggetto sociale

3.1. La società ha per oggetto principalmente, ma non solo, le seguenti attività nel campo della comunicazione e del marketing digitale e non digitale, come segue, ma senza limitazioni:

3.1.1. Nello specifico:

a) Lo sviluppo, la produzione, la gestione e la commercializzazione di prodotti e/o servizi innovativi ad alto valore tecnologico, servizi informatici e telematici innovativi;
b) La consulenza assistita nel settore delle tecnologie dell'informatica ad alto valore tecnologico;
c) Lo sviluppo software innovativi, sistemi di gestione informatica sul web ed app per dispositivi mobili;
d) La progettazione, la gestione e la consulenza per creazione hardware, software ed applicazioni web innovative e ad alto valore tecnologico;
e) L'assistenza tecnica connessa ai prodotti informatici innovativi ad alto valore tecnologico;
f) Lo sviluppo delle attività SEO, il posizionamento e lo sviluppo dei siti web e professionali, la pubblicità e la promozione di attività commerciali sul web con metodologie innovative;

A2021053540019033162

g) Gestione di riviste, periodici, quotidiani e siti sul web con finalità anche di favorire la diffusione della cultura di impresa e promuovere le attività imprenditoriali sul web;

h) Creazione e gestione attività di telecomunicazioni con l'utilizzo di strumenti tecnologicamente evoluti ed innovativi e/o qualsiasi attività nell'ambito della ICT ad alto contenuto tecnologico ed innovativo;

i) Grafica web ed editoriale, campagne di marketing innovative, ideazione e registrazione loghi, marchi e brevetti, stampa tipolitografica e su qualsiasi materiale, gadget, brochure, presentazioni on line e produzioni su altri supporti;

j) Creazione, sviluppo, gestione, consulenza assistita per la specifica attività del social media marketing e tutte le attività di marketing innovative e che fanno uso di strumenti ad alto valore tecnologico;

k) Elaborazione di business plan e piani di impresa per progetti di finanziamento pubblico e privato e controllo di gestione, con particolare riferimento ai progetti innovativi e ad alto valore tecnologico;

l) Corsi di formazione liberi ed autorizzati da enti pubblici con l'ausilio di strumenti tecnologicamente evoluti ed innovativi;

m) Organizzazione e gestione convegni, meeting, congressi, fiere e contesti nel quale sviluppare l'informazione, conoscenza e socializzazione prevalentemente sulla rete e sulle tematiche dell'innovatività e delle idee di impresa ad alto contenuto tecnologico;

n) Elaborazione, gestione e distribuzione dei big data relativi a tutte le attività svolte;

o) La prestazione di servizi nel campo della comunicazione, del marketing digitale e delle vendite, che includerà, ma non solo, la realizzazione degli spot pubblicitari, la vendita e la promozione dei prodotti *online*, il social media marketing, la pubblicità *display*, *e-book*, la creazione e la promozione dei video, giochi *online*, la creazione e la promozione di varie applicazioni, la creazione e la vendita dei siti web, lo sviluppo della tecnologia e delle sue forme nei settori della Comunicazione, del Marketing digitale e delle Vendite, nonché qualsiasi altra forma di media;

p) La comunicazione con i clienti, i consumatori e le relazioni con il pubblico;

q) La partecipazione, il finanziamento, la sponsorizzazione e/o la realizzazione dei progetti relativi alla prestazione dei servizi nei settori della comunicazione, del marketing digitale e delle vendite;

r) La società ha inoltre per oggetto la gestione, sia in proprio che con partecipazioni esterne, di qualsiasi tipo di licenza, concessione e simili, la compravendita di aziende commerciali, il pagamento e/o l'incasso di royalties, la gestione di joint-ventures, franchising, la stipula di tipologie similari di accordi e/o collaborazioni con terzi, sia in Albania che all'estero (sia in conto proprio che per conto altrui).

3.1.2. Inoltre, la società ha ad oggetto anche la comunicazione non web che include le seguenti attività:

a) La promozione e la conclusione, in proprio e per conto terzi, di contratti pubblicitari in genere con privati, società, ditte ed enti pubblici e privati interessati alla pubblicizzazione di prodotti su giornali, riviste, opuscoli, periodici, in mostre e manifestazioni di qualsiasi genere sia in Albania che all'estero;

b) L'organizzazione e la conduzione per conto terzi di uffici stampa inerenti al settore cinematografico, televisivo, teatrale, manifestazioni turistiche, sportive e dello spettacolo in genere;

NOTER DUSHAJ TIRANË
A2021053540019033162

c) L'ideazione, la realizzazione, l'allestimento, la gestione di eventi, conferenze, convegni, presentazioni, seminari, performance, concerti, sfilate, mercatini, fiere, esposizioni, mostre, installazioni, concorsi.

3.2. Inoltre, la società ha ad oggetto anche le seguenti attività nel settore immobiliare:

a) Il godimento, la gestione, l'affitto, il subaffitto, il comodato e l'amministrazione di beni immobili di qualsiasi natura e specie;
b) La gestione di strutture alberghiere, residence, case vacanze, *bed and breakfast* e l'esercizio di qualsiasi attività ricettivo-turistiche in genere sia in locali propri che di terzi;
c) La realizzazione di opere edili di qualunque tipo e natura ivi compresi la costruzione, la ristrutturazione di beni immobili e il miglioramento di beni immobili in genere, nonché l'acquisto, la vendita, la permuta di beni immobili di qualunque tipo e natura.

3.3. La Società potrà acquisire partecipazioni azionarie o non azionarie in altre società, enti, consorzi, costituiti o costituendi, albanesi oppure esteri, aventi oggetto analogo o comunque connesso o complementare al proprio o comunque funzionali al raggiungimento degli scopi sociali.

3.4. Più in generale, la Società potrà compiere qualsiasi altra attività che, anche se non correlata a quanto sopra previsto, non costituisce un'attività proibita dalla legge ed è funzionale all'attuazione dell'oggetto sociale.

### Art. 4 – Sede

4.1. La sede legale della società è a Tirana (Albania), Via "Zonja Çurre", Edificio n. 31, Scala n. 4, Interno n. 2, Unità amministrativa n. 2, 1010, Tirana, Albania.

4.2. Il trasferimento della sede della società in un altro luogo avverrà con la deliberazione del Socio unico.

4.3. Il Socio unico potrà decidere l'apertura di filiali, rami e rappresentanze in altre città dell'Albania ed anche all'estero.

### Art. 5 - Durata

5.1. La durata della società è a tempo indeterminato, a partire dalla data della sua registrazione presso il Centro Nazionale del Business.

## CAPITOLO II
## CAPITALE SOCIALE, CONFERIMENTI, RIPARTIZIONE DELLE QUOTE SOCIALI

### Art. 6 - Capitale sociale

6.1. Il capitale sociale è di 100 (cento) Lekë.

6.2. Il capitale sociale è composto da 1 (una) quota, avente il valore di 100 (cento) Lekë.

### Art. 7 - Conferimenti e quote

7.1. Il capitale sociale è pari a 100 (cento) Lekë ed è di proprietà del socio unico come segue: **Alessio Rinelli**, figlio di Ruggiero, cittadino italiano, nato il 07 giugno 1983 a Cernusco sul Naviglio, Milano (Italia), titolare della carta di identità italiana n. CA76512DJ, numero di telefono +355675034568, che è il proprietario dell'intero capitale sociale di "TATAMI GROUP" S.r.l.

### Art. 8 - Aumenti del capitale sociale

8.1. Il capitale sociale potrà essere aumentato senza limiti in qualsiasi momento, una o più volte, con la deliberazione del Socio unico.

8.2 In caso di deliberazione di aumento del capitale sociale, le quote già esistenti possono essere aumentate secondo le somme determinate nella delibera sull'aumentazione del capitale.

8.3

### Art. 9 - Riduzione del capitale sociale

9.1. La società può ridurre il capitale sociale previa deliberazione del Socio unico. In ogni caso il capitale sociale non può essere ridotto al di sotto del minimo previsto dalla legge.

9.2. La riduzione del capitale è sopportata dal socio secondo le somme determinate nella delibera sulla riduzione del capitale.

### Art. 10 - Trasferibilità delle quote

10.1. Le quote sono liberamente trasferibili secondo l'art 73 della Legge n. 9901 del 14.04.2008 "*Sui Commercianti e le Società Commerciali*", e successive modifiche.

## CAPITOLO III
## SOCIO UNICO, AMMINISTRATORI ED ESPERTO CONTABILE

### Art. 11 – Il Socio unico

11.1. L'organo deliberativo della società è il Socio unico.

11.2. Il socio ha il diritto di farsi rappresentare da altra persona, munita di semplice procura scritta, attraverso la quale potrà esprimere il proprio voto.

11.3. Il Socio unico può inoltre essere convocato in qualsiasi momento dall'Amministratore. In ogni caso, il Socio unico dovrà prendere decisione almeno una volta all'anno per esaminare e approvare il bilancio del precedente esercizio finanziario.

11.4. Il Socio unico, se convocato dall'Amministratore, deve essere convocato a mezzo lettera raccomandata fatta pervenire ai soci – nel domicilio risultante dai documenti della società – almeno 7 (sette) giorni prima del giorno fissato per l'incontro. La convocazione deve contenere le materie da trattare e da deliberare, il luogo, l'ora e la data della convocazione.

11.5. Il Socio unico può prendere decisioni anche fuori della sede sociale, in Albania oppure all'estero.

## Art. 12 – Amministrazione

12.1 La società è amministrata da 1 (uno) Amministratore, nominato dal Socio unico, il quale rimane in carica fino a revoca o dimissioni oppure per un periodo di 5 (cinque) anni. L'Amministratore è rieleggibile per lo stesso periodo.

12.2 La rappresentanza legale della società spetta all'Amministratore. L'amministratore compirà tutti gli atti di ordinaria e straordinaria amministrazione della società, salvo le competenze riservate ad altri organi della società dalla legge applicabile o dal presente statuto.

12.3 L'Amministratore può nominare procuratori speciali per singoli atti o categorie di atti.

12.4 La Società è amministrata da 1 (uno) Amministratore, **Alessio Rinelli**, figlio di Ruggiero, cittadino italiano, nato il 07/06/1983 a Cernusco sul Naviglio, Milano (Italia), titolare della carta di identità italiana n. CA76512DJ, maggiorenne, con piena capacita di agire, indirizzo mail alessio.rinelli@gmail.com, numero di telefono: +355675034568, nominato dal Socio Unico, il quale rimane in carica fino a revoca o dimissioni oppure per un periodo di 5 (cinque) anni. L'Amministratore è rieleggibile per lo stesso periodo.

## Art. 13 - Esperto contabile autorizzato

13.1. Qualora richiesto dalla legge o deliberato dal Socio unico, il controllo dei bilanci d'esercizio e dei libri contabili della società sarà affidato ad un esperto contabile autorizzato.

# CAPITOLO IV
# ANNO FINANZIARIO, BILANCIO ANNUALE, DISTRIBUZIONE DEGLI UTILI

## Art. 14 - Anno finanziario e bilancio annuale

14.1. L'anno finanziario inizia il 1 gennaio e termina il 31 dicembre di ogni anno.

## Art. 15 – Utili

15.1 Gli utili netti risultati dal bilancio annuale dedotto gli eventuali accantonamenti deliberati dal Socio unico, sono distribuiti al Socio, o con la sua deliberazione vengono reinvestiti o capitalizzati all'interno della società.

15.2 Il Socio Unico potrà peraltro deliberare speciali prelevamenti a favore di riserve straordinarie o per altre destinazioni oppure il rinvio della distribuzione degli utili – in tutto od in parte – ai successivi esercizi.

# CAPITOLO V
# SCIOGLIMENTO E LIQUIDAZIONE DELLA SOCIETÀ

## Art. 16 – Scioglimento

16.1. La società si scioglie nei casi previsti dalla legge o per decisione del Socio unico.

16.2. La società non si scioglie in caso di fallimento del socio.

**Art. 17 – Liquidazione**

17.1 Nel caso di scioglimento la società verrà posta in liquidazione.

17.2 Per gestire questa procedura, il Socio unico nominerà uno o più liquidatori i quali presenteranno la relazione finale sullo stato dell'attivo e del passivo della società, sulle operazioni di liquidazione e sui tempi necessari per portare a termine la liquidazione.

17.3 Al termine della procedura di liquidazione il Socio unico deciderà sul bilancio finanziario definitivo, sulla validità del lavoro svolto dal liquidatore e sulla fine dell'operazione di liquidazione.

17.4 Dopo il pagamento dei creditori e la riscossione dei crediti, il liquidatore/i distribuirà i proventi finali della liquidazione al socio.

**Articolo 18 – Lingua**

18.1. Il presente atto costitutivo statuto è redatto in 3 (tre) copie in lingua albanese e 3 (tre) copie in lingua italiana.

**Articolo 19 – Disposizioni finali**

19.1. Per quanto non specificato espressamente dal presente statuto sarà applicata la legge albanese sulle società commerciali.

19.2. Per tutte le controversie che dovessero insorgere sarà competente il tribunale di Tirana.

Il Notaio ha verificato l'identità delle parti tramite documenti di identità e dopo aver trovato il contenuto del suddetto atto notarile nel pieno rispetto degli articoli 62, 63 e seguenti della Legge n. 110/2018 "Sul Notaio", ho letto alla parte, che, alla presenza del traduttore Fjoralba Zeko, lo ha dichiarato integralmente secondo sua volonta e attesto la sua firma. Ai sensi della Legge 9887, del 10.03.2008 "Tutela dei dati personali", Io Notaio dichiaro che conserverò e tratterò i dati personali dei soggetti del presente Atto costitutivo e del presente Statuto, in modo corretto e lecito.

**FONDATORE**

**ALESSIO RINELLI**

**INTERPRETE**

**FJORALBA ZEKO**

**NOTAIO**

**MIMOZA SADUSHAJ**